ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS
CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA

ZGJEDHJET PER KUVENDIN E OFK-SE 2026

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të nenit 9, paragrafët 1 dhe 2, 6 13 , dhe nenit 31 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OFK-së, nr. 275, datë 30.12.2024, në mbledhjen e mbajtur më 30.04.2026, nxjerr këtë:

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komsioni Qendror i Zgjedhjeve
Nr 25 Datë 30/04/26

VENDIM

Për miratimin e formularit të kandidimit për anëtar/e të Kuvendit të OFK-së

I. Miratohet formulari zyrtar për kandidim për anëtar/e të Kuvendit të Odës së Farmacistëve të Kosovës, i cili do të përdoret nga kandidatët gjatë procesit të kandidimit për zgjedhjen e anëtarëve të Kuvendit të OFK-së. Formulari i miratuar i bashkangjitet këtij vendimi.

II. Formulari i kandidimit duhet të përmbajë së paku këto elemente minimale:

Të dhënat për njësinë zgjedhore në të cilën kandidati/ja kandidon; të dhënat personale dhe profesionale të kandidatit/es, përfshirë emrin, mbiemrin, datën e lindjes, numrin e licencës, numrin kontaktues dhe adresën elektronike; deklaratën e kandidatit/es për saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave të paraqitura; deklaratën se kandidati/ja është i/e njoftuar me procedurën, rregullat zgjedhore dhe rregullat e sjelljes zgjedhore, si dhe me pasojat që mund të rrjedhin nga mosrespektimi i tyre.

Formulari duhet të përmbajë gjithashtu pjesën për mbështetësit e kandidatit/es, ku shënohen të dhënat e së paku pesë (5) mbështetësve nga njësia përkatëse zgjedhore, përfshirë emrin dhe mbiemrin, numrin personal, numrin e licencës, datën e nënshkrimit dhe nënshkrimin e secilit mbështetës.

III. Pjesë përbërëse e formularit është edhe deklarata e mbështetësve, përmes së cilës ata deklarojnë se mbështetjen për kandidatin/en e kanë dhënë me vullnet të lirë, pa presion, ndikim të padrejtë, kërcënim apo kushtëzim, si dhe se kanë mbështetur vetëm një kandidat/e për anëtar/e të Kuvendit të OFK-së.

IV. Formulari i kandidimit, së bashku me rregullat e sjelljes zgjedhore dhe udhëzimet përkatëse për kandidim, publikohet në ueb-faqen zyrtare të OFK-së dhe vihet në dispozicion të kandidatëve gjatë afatit të kandidimit.

V. Kandidaturat e dorëzuara jashtë formularit të miratuar me këtë vendim nuk konsiderohen të rregullta, përveç rasteve kur KQZ vlerëson se mangësitë janë të natyrës teknike dhe mund të plotësohen brenda afatit të përcaktuar.

VI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

I dërgohet:

Anëtarëve të OFK-së;

Sekretariatit të KQZ-së.

Kryetari i KQZ-së

Mr.Ph. Betim Ramadani

Ramadani

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komsioni Qendror i Zgjedhjeve
OFK - KQZ